



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 08, datë 27.07.2022

**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 12, DATË 27.02.2019 TË  
KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT "PËR MIRATIMIN E LEJEVE TË  
ZHVILLIMIT/NDËRTIMIT NGA AUTORITETET E ZHVILLIMIT TË  
TERRITORIT, NË NJËSITË QË I PËRKASIN SISTEMEVE URBAN (UB),  
BUJQËSOR (B) DHE NATYROR (N)"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, të Ligjit Nr. 79/2017 "Për Sportin", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 22, datë 12.01.2018, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kriterëve e të procedurave për çertifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 283, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore", i ndryshuar dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozimin e Agjencisë Kombëtare për Planifikimin e Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Në Vendimin Nr. 12, datë 27.02.2019 të KKT-së "Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)", bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:
  - Tek pika 1 shtohet gërma c) me përmbajtje si më poshtë:
    - c) *Objekte sportive, ambiente sportive, terrene sportive dhe mjedise sportive ku zhvillohen një ose disa sporte, në bazë të rregullave teknike, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sektorial.*
  - Pika 4 ndryshohet sipas formulimit të mëposhtëm:
    4. *Nëse nuk përcaktohet ndryshe në pasaportën e njësisë strukturore përkatëse, sipas dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, apo nga legjislacioni sektorial në*

*fuqi, strukturat agroturistike nuk duhet të kalojnë lartësinë 2 kate me nënçati, ndërsa strukturat sportive, të cituara në gërmën c) të pikës 1, duhet të zbatojnë standartet dhe kushtet teknike të projektimit për objekte, ambiente, terrene dhe mjedise sportive.*

- Pika 5 ndryshohet sipas formulimit të mëposhtëm:

*5. Riparimi, rinovimi, shtesat dhe përshtatja e strukturave ekzistuese të funksioneve të ndryshme, në struktura në funksion të agroturizmit dhe sportive është e lejuar me përmbushjen e përcaktimeve të këtij vendimi dhe në çdo rast duke respektuar legjislacionin sektorial në fuqi. Shtesat në strukturat ekzistuese duhet të jenë në respektim të pikës 4 të këtij vendimi.*

- Pika 6 ndryshohet sipas formulimit të mëposhtëm:

*6. Autoritetet e zhvillimit të territorit duhet të vijnë me miratimin e kërkesave për leje zhvillimi/ndërtimi për rastet sipas pikës 1 të këtij vendimi, vetëm pas:*

- a. marrjes së konfirmimit nga Ministria e Linjës dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit për pikën 1, gërmat a) dhe b);*
- b. marrjes së konfirmimit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit për pikën 1, gërma c);*
- c. njoftimit të Këshillit Kombëtar të Territorit.*

- Pika 7 ndryshohet sipas formulimit të mëposhtëm:


*7. Pas ndërtimit të objekteve për prodhimin, ruajtjen, përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, strukturave të agroturizmit dhe objekteve sportive, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe të legjislacionit sektorial në fuqi, nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të tyre në vijimësi.*

3. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe autoritetet përgjegjëse të zhvillimit të territorit për zbatimin e këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

